

Data: 12/08/21 Ref.: 3010/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113(Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037(Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2026:

- Psikologji, BA, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik;
- Psikologji Shkollore dhe Këshillim, MA, 120 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;

II. Riakreditohen programet e studimit, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:

- Punë Sociale, BA, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- Filozofi, MA, 120 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik;
- Studime Evropiane dhe Administratë Publike, MA 120 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik;
- Sociologji, MA, 120 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- Arkivistika, MA, 60 ECTS, maksimumi 22 studentë për vit akademik;

III. Akreditohen programet e studimit, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:

- Shkencë Politike me specializim: 1. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci; 2. Administrim Publik, BA, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik;
- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik;

IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.

V. Obligohet Fakulteti Filozofik që deri më 15 nëntor të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Fakulteti Filozofik, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Psikologji, BA, 180 ECTS	Dashmir Bërxulli Liridona Jemini – Gashi Kaltrina Kelmendi Natyra Agani
2	Psikologji Shkollore dhe Këshillim, MA, 120 ECTS	Aliriza Arënliu Zamira Hyseni
3	Punë Sociale, BA, 180 ECTS	Lulzim Dragidella Vjollca Krasniqi Njomza Llullaku
4	Filozofi, MA, 120 ECTS	Hasnije Ilazi Kristë Shtufi
5	Studime Evropiane dhe Administratë Publike, MA 120 ECTS	Arben Hajrullahu Jehona Lushaku
6	Sociologji, MA, 120 ECTS	Sabri Kiçmari Shemsi Krasniqi Gëzim Selaci
7	Arkivistika, MA, 60 ECTS	Ibrahim Gashi
8	Shkencë Politike me specializim: 1. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci; 2. Administrim Publik, BA, 180 ECTS	Adem Beha Bardhok Bashota Ardian Kastrati Zenun Halili
9	Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS	Bekim Baliqi Anton Vukpalaj

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar një vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Filozofik me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 11.03.2021, 16.03.2021 dhe 12.05.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Vlatko Cvrtila, Artur Tventarnii, Sonja Kacar, Juraj Bogat, Robert Masten, Kristijan Kotarski, Melita Kovacevic, Anna Bara.


Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të Ekspertëve Ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Psikologji, BA, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht shtatë (7) kapituj.
2. Për programin e studimit Psikologji Shkollore dhe Këshillim, MA, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht shtatë (7) kapituj.

3. Për programin e studimit Punë Sociale, BA, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht një (1) kapitull, substancialisht pesë (5) kapituj dhe pjesërisht një (1) kapitull.
4. Për programin e studimit Filozofi, MA, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht gjashtë (6) kapituj dhe pjesërisht një (1) kapitull.
5. Për programin e studimit Studime Evropiane dhe Administratë Publike, MA 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht tre (3) kapituj.
6. Për programin e studimit Sociologji, MA, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht tre (3) kapituj.
7. Për programin e studimit Arkivistika, MA, 60 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht një (1) kapitull dhe substancialisht gjashtë (6) kapituj.
8. Për programin e studimit Shkencë Politike me specializim: 1. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci; 2. Administrim Publik, BA, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht pesë (5) kapituj dhe pjesërisht dy (2) kapituj.
9. Për programin e studimit Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht pesë (5) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht dy (2) kapituj.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 korrik 2021 kanë shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit Filozofik dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.